

**BARKODI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS**  
**AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

**PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010****S E S I O N I I****(I DETYRUAR)****VARIANTI A****E martë, 1 qershor 2010****Ora 10.00**

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**  
**Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në dramë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

| Kërkesa | 1   | 2   | 3   | 4   | 5  | 6  | 7  | 8a | 8b | 9  | 10a | 10b | 11  | 12  |
|---------|-----|-----|-----|-----|----|----|----|----|----|----|-----|-----|-----|-----|
| Pikët   |     |     |     |     |    |    |    |    |    |    |     |     |     |     |
| Kërkesa | 13a | 13b | 13c | 13d | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20  | 21  | 22a | 22b |
| Pikët   |     |     |     |     |    |    |    |    |    |    |     |     |     |     |
| Kërkesa | 23  | 24a | 24b | 25  |    |    |    |    |    |    |     |     |     |     |
| Pikët   |     |     |     |     |    |    |    |    |    |    |     |     |     |     |

**Totali i pikëve**

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2. ....Anëtar

## PJESA I

### PETRO MARKO

#### Nata e Ustikës (*fragment*)

Në fillim ndjeva zërin e saj. Pastaj i preka duart. Fytyrën nuk ia pashë. As trupin. Kishte diçka thellësish njerëzore në ato duar. M'u duk se në pëllëmbën time pulsonte një zemër. Rrahjet e saj u bënë njësh me të miat. Nuk i shihja dot ato duar. Vetëm sa i prekja. Mos ishte nata ajo që i vishte me mister? Apo hekurat e burgut që na ndanin? Ndoshta të dyja bashkë, ndoshta asnjëra prej tyre.

Përjashta kishte rënë agimi me një dritë të madhërishme mbi det e mbi gurë. Se vetëm gurë kishte këtej dhe det në të katër anët. I shtangur nga ky agim i parë përjashta pas kaq kohësh, eca dhe eca nga krahu i mëngjér. Kapërceva nja dy baraka të mëdha dhe u ula në një copëz lëndinë. Pastaj u shtriva mbi barin e tharë. Shikoja qiellin e ndriçuar dhe s'mendoja asgjë. Se, kur shikon qiellin e pafund, s'ke ç'mendon. Çdo mendim ka frikë të dalë, se humbet në atë hapësirë të zbrazët.

Ndjeva një shkelm të fortë në kofshë.

U ngrita përgjysmë se më dhemb shumë kofsha ime e holluar. Një zotni, i veshur mirë, më shikonte me inat:

- Çohu të them! Ç'bën këtu?
- Po pres diellin! - i thashë.

Andrea! Moj Andrea!

Sooonja! Ti?

Andrea! Moj Andrea!

Sonja? Ti këtu?

Doktori vizitonte të sëmurët. Unë, sikur kisha në tru gjithë pleshtat e natës që kaloi, s'dija ç'të bëja... Si ishte Sonja? Po pse me tha "kam fat unë"? Po si ishte e mundur ta takoja këtu? Po pse nuk i fola më gjatë? Si duhej ta nisja bisedën?

Mendimet e mia ishin bërë shkrumb si barërat e djegura nga dielli. Aty për aty s'dija se ç'do tē ngjiste. Po, me t'u afruar në derën e madhe të kështjellës, u ndalëm.

- Kjo është hyrja e kalvarit. Kalvar quhet kjo kështjellë. Atje lart, në atë vend të rrënuar, ishin shkruar vargjet e Dantes.

"Lasciate ogni speranza voi ch`entrate!"<sup>1</sup>

Dhe me duar të dredhura hiqte një zinxhir të ndryshkur e të trashë, si atë të ankorës së vaporëve të mëdhenj. E ndihmova për të shtyrë një kanatë të derës gjigante prej hekuri. Hekuri përvëlonët nga dielli. Dera ulëriu si një kukuvajkë.

Me të celur derën, hymë në një korridor-tunel të errët. Me zuri frika. Si në tregimet e Edgar Po-es. Doktori shikonte qelitë e prishura. Numëronte.

- Këtu fillon. Një, dy, tre, katër....dhjetë!

Ecnim si dy hije ne atë hije të rëndë mortore.

Dymbëdhjetë .... Trembëdhjetë....Ja dhe qelia... ose me mirë kuvlia e hekurt numër 14 -dhe u ndal. Dhe mori drejtqëndrim. Dhe nisi dënesat. Kokulur. Qante.

Unë, i pushtuar nga një ndjenje frike dhe tmerri ...shikoja atë qeli të ngushtë gjithë hekur të ndryshkur. Në mure e përposh shpendra dhe hithra. Disa zhapinj shkuant për t'u fshehur.

<sup>1</sup> O ju që hyni, lini çdo shpresë!

Këtu dha shpirt yt atë! - Toni i trishtuar i zërit të tij ma bënte më të trishtuar atë kuvli hekuri të ndryshkur. - Po ja ku të betohem, në këtë kalvar të betohem, o Giorgio i gjorë, se djalin tënd nuk do ta le të vdesë, edhe biri im le të vdesë, po Andrea yt nuk duhet të vdesë. Dhe s'do të vdesë. Për këtë të betohem si njeri, si kristian, si mjek, si Italian, si antifashist... dhe ngriti doren. Pastaj bëri kryqin.

*Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni alternativën e saktë.*

1. Petro Marko, me krijimtarinë e tij afron me shkrimtarët: **1 pikë**
  - A) e realizmit magjik
  - B) ekzistencialistë
  - C) e brezit të humbur
  - D) romantikë
  
2. Ngjarjet në roman rrëfehen nga: **1 pikë**
  - A) autori
  - B) Andrea Bora
  - C) doktori italian
  - D) një dëshmitar i ngjarjeve
  
3. Në fjalinë: “*Çdo mendim ka frikë të dalë, se humbet në atë hapësirë të zbrazët.*” është përdorur figura: **1 pikë**
  - A) e alegorisë
  - B) e metaforës
  - C) e metonimisë
  - D) e paralelizmit figurativ
  
4. Folja e nënvizuar në fjalinë: “*Cohu të them!*” është në mënyrën: **1 pikë**
  - A) dëftore
  - B) dëshirore
  - C) habitore
  - D) urdhërore
  
5. Cili nga mbiemrat e mëposhtëm është përdorur me kuptim *të drejtpërdrejtë*? **1 pikë**
  - A) Barërat e djegura
  - B) Dera gjigante
  - C) Hapësirë të zbrazët
  - D) Hije të rëndë mortore
  
6. Fjala *kokulur* nga pikëpamja e ndërtimit është: **1 pikë**
  - A) e përbërë
  - B) e prejardhur
  - C) e përngjitur
  - D) e thjeshtë

7. Në takimin me Sonjën, Andrea e përqendron vëmendjen në ndjesinë që i shkaktojnë duart e saj. Pse pikërisht duart? Çfarë kanë ato kaq të veçantë, që djalit i mbeten në mendje?

**2 pikë**


---



---

**8.**

- a) Cila është gjendja emocionale e Andreas pas takimit me Sonjën (pjesa III)? **1 pikë**

---



---

- b) Ç’lloj fjalie, sipas kumtimit, ka përdorur autor i një rast? Si do ta shpjegonit këtë mënyrë përdorimi? **2 pikë**

---



---

9. Në paragrafin e dytë përshkruhet natyra plot jetë. Cili është funksioni artistik i një përshkrimi të tillë? Ç’theksohet përmes kësaj zgjedhjeje?

**2 pikë**


---



---

**10.**

- a) Identifikoni në fragmentin e dhënë një fakt autobiografik, që lidh heroin e veprës me jetën e autorit. **1 pikë**

---



---

- b) Gjeni në pjesën e tretë një fjalë njëkryegjymtirëshe emërore dhe një foljore. **2 pikë**

- fjalë njëkryegjymtirëshe emërore: \_\_\_\_\_

- fjalë njëkryegjymtirëshe foljore: \_\_\_\_\_

11. Doktori betohet se do ta mbrojë Andrean. Ç’e shtyn atë të bëjë një betim të tillë?

Përse autor i ka diferencuar atë nga italianët e tjerë në ishullin-burg dhe çfarë ka dashur ai të mishërojë përmes kësaj figure? **3 pikë**

---



---



---

12. Pse autor i referohet pikërisht vargjeve të Dantes? Me ç’nëntekst është përdorur vargu i marrë nga “Ferri”: *“Lasciate ogni speranza voi ch’entrate!”* (*O ju që hyni, lini çdo shpresë!*)?

**2 pikë**


---



---



---

- 13.** Nisur nga fjalët e Andreas: “*Po pres diellin...*” argumentoni në formën e një eseje se *bota i takon ditës dhe jo natës*. **8 pikë**

| Shtjellimi i idesë (13a) | Organizimi dhe struktura (13b) | Stili dhe origjinaliteti (13c) | Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (13d) | <b>Totali</b> |
|--------------------------|--------------------------------|--------------------------------|--|---------------|
| <b>2 pikë</b>            | <b>2 pikë</b>                  | <b>2 pikë</b>                  | <b>2 pikë</b>  | <b>8 pikë</b> |

## PJESA II

### Euripidi

#### **Medea (*fragment*)**

#### **Medea**

O Zeus, o Dike, bijë e Zeusit!  
 Ti, o drit e Diellit! Ja tani moj shoqe,  
 do të korr fitore kundër armiqve të mi.  
 Tani m'u rrit shpresa, se armiqt e mi  
 kanë për t'u dënuar. Vërtetë ky njeri  
 tamam n'atë kohë q'ish rrezik i madh,  
 si një port, si strehë, m'erdh për planin tim.  
 Tani do të të them  
 të gjithë ato plane që kam përgatitur.  
 Një nga shërbëtorët kam për ta dërguar  
 drejt te Jasoni, t'i thotë nga unë  
 që do të vijë vetë; pastaj si të vijë,  
 do ta pres me fjalë t'ëmbla e të buta:  
 do t'i them për shembull se çdo gjë u bë,  
 është bërë mirë, edhe do t'i lutem  
 të ndërmjetësojë që fëmija ime  
 këtu të qëndrojë; jo se dëshiroj  
 t'i lë këtu djemtë, në një vend armik,  
 po pse kam ndërmend të vras me dredhi  
 bijën e monarkut.  
 Me djemtë dhurata do t'i dërgoj nuses:  
 një fustan të hollë, një kurorë t'artë;  
 e pasi t'i marr dhe t'i mveshë në trup,  
 të gjejë vdekjen shumë të tmerruar  
 e jo ajo vetëm, po dhe kushdo tjetër  
 që do t'i afrohet. Ja me çfarë ilaqesh  
 do t'i lyej unë dhuratat e nuses.  
 Po këtë bisedë e këput këtu.  
 Dridhem kur mendohem çdo të bëj më pas:  
 do t'i vras fëmijët: asnjeri nga vdekja  
 s'mund që të shpëtojë: do t'ia kthej përmbyss  
 shtëpinë Jasonit: dhe si të mbaroj  
 punën gjakësore, do dal prej Korintit,  
 do të iki larg, që të mos e shoh  
 vendin e shkretuar, ku i vrava djemtë,  
 se s'duroj dot, shoqe, talljet e armiqve.  
 Haj pra, për ta jeta ç'gëzim do të ketë?  
 S'ka atdhe për mua, nuk ka shtëpi,  
 as dhe ndonjë strehë për rrezikun tim.

Bëra faj atëherë kur e lash vatrën,  
 vatrën e tim eti: duke iu bindur  
 fjalës së një greku: po këtij njeriu  
 me ndihmën e hyjve hakun do t'ia marr.  
 Që tani e tutje ky s'ka për të parë  
 as ata fëmijë që i kam lindur unë,  
 as fëmijë të tjerë do t'i lindë nusja,  
 do të vdesë, do shuhet.  
 Askush mos më marrë për grua të keqe,  
 për një të sëmurë ose për të urtë:  
 po përkundër unë për miqt' jam e mirë,  
 për armiqt' e ligë.

#### **Kori**

Meqë na tregove planet që ke bërë,  
 për të mirën tënde dhe për hir të ligjit,  
 të them: mos i bëj.

#### **Medea**

S'ka si bëhet ndryshe; ti ke plot të drejtë  
 këto të m'i thuash, se s'pëson si unë.

#### **Kori**

Do guxosh, moj grua, djemtë e tu të vrasësh?

#### **Medea**

Po, se kështu vetëm burri im do digjet.

#### **Kori**

Po dhe ti do bëhesh grua më e mjerë.

#### **Medea**

Mori fund, mbaroi; fjalët janë të tepërtë.  
 (Duke iu drejtuar Mëndeshës)  
 Po ti nisu, ecë, e ma thirr Jasonin,  
 sepse ty të kemi njeri të besuar.  
 Shih mos ia thuash njeriu planin,  
 Në i do tët zotër edhe në je grua.

Për pyetjet nga 14 deri në 20 rrethoni alternativën e saktë.

**14.** Subjektin për tragjedinë *Medea*, Euripidi e mori nga:

**1 pikë**

- A) *Iliada* e Homerit
- B) galeria eskiliane
- C) jeta e përditshme athinase
- D) mitologjia greke

**15.** Konfliktin kryesor Medea e ka me:

**1 pikë**

- A) qytetarët e Korintit.
- B) mbretin dhe të bijën.
- C) Jasonin.
- D) vëllezërit dhe të atin.

**16.** Medea vendos t'i vrasë djemtë, sepse:

**1 pikë**

- A) do të hakmerret kundër Jasonit.
- B) ndien urejtje për nusen e re.
- C) urren për vdekje mbretin Kreon.
- D) do t'i flijojë për perënditë.

**17.** Në cilin prej vargjeve të mëposhtme është përdorur antonimia?

**1 pikë**

- A) për një të sëmurë ose për të urtë
- B) do ta pres me fjalë t'ëmbla e të buta
- C) një fustan të hollë, një kurorë t'artë
- D) po përkundër unë për miqt' jam e mirë, /për armiqt' e ligë

**18.** Pasi të realizojë planin e saj të tmerrshëm, një nga arsyet që Medea mendon të largohet nga Korinti është, sepse:

**1 pikë**

- A) ka frikë nga hakmarrja e Jasonit.
- B) ka frikë nga hakmarrja e qytetarëve.
- C) nuk do të shikojë më vendin ku vrah fëmijët.
- D) dëshiron të rikthehet dhe të gjejë paqe në atdheun që braktisi.

**19.** Arsyja e dëshpërimit të Medeas është:

**1 pikë**

- A) largimi nga atdheu.
- B) sjellja e të shoqit.
- C) pritja që i bënë qytetarët e Korintit.
- D) përbuzja që gratë e Korintit kanë për të.

**20.** Në cilin prej vargjeve të mëposhtme është përdorur fjalia e thjeshtë?

**1 pikë**

- A) Bëra faj atëherë kur e lash vatrën.
- B) Po ti nisu, ecë, e ma thirr Jasonin.
- C) Askush mos më marrë për grua të keqe.
- D) Do guxosh, moj grua, djemtë e tu të vrasësh?

**21.** Në fjalën e saj Medea shfaq disa gjendje shpirtërore. Zbuloni dy prej tyre. **2 pikë**

---



---

**22.**

a) A mendoni se Medea është një grua dinake? Pse? Mendimin tuaj ilustrojeni me vargje nga fragmenti. **3 pikë**

---



---



---

b) Cila është arsyja që Medea përmend atdheun, babanë dhe familjen? Si ndihet ajo? **2 pikë**

---



---

**23.** Lexoni me kujdes vargun: *Mori fund, mbaroi; fjalët janë të tepërtë. Ç’raport kuptimor krijojnë midis tyre fjalët mori fund dhe mbaroi?* Çfarë thekson ky përdorim? **2 pikë**

---



---

**24.**

a) Ç’rol luan kori në këtë tragjedi? **1 pikë**

b) Kori parashtron dy arsyje para Medeas, me qëllim që ta pengojë atë për të vënë në jetë planin e saj. Cilat janë ato? **2 pikë**

arsyea 1: \_\_\_\_\_

arsyea 2: \_\_\_\_\_

**25.** A mendoni se Medea është e justifikuar për veprën që do të kryejë? Mendimin tuaj mbështeteni me shembuj nga fragmenti. **2 pikë**

---



---



---